

VENDIM
Nr. 30, datë 18.1.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË MARRËVESHJEN E KONCESIONIT LIDHUR ME
PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, PRONËSINË, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E NJË PROJEKTI PËR NJË
HIDROCENTRAL TË RI NË ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË, NDËRMJET
MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIËS (AUTORITETI KONTRAKTUES)
DHE VERBUND AG (KONCESIONARI) DHE ENERGJI ASHTA SHPK (SHOQËRIA E
PROJEKTTIT)”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1363, DATË 17.10.2008, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes shtesë të koncensionit “Për disa ndryshime dhe shtesa në marrëveshjen e koncesionit lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një projekti për një hidrocentral të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë, ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoriteti Kontraktues) dhe VERBUND AG (Koncesionari) dhe Energji Ashta sh.p.k. (Shoqëria e projektit)”, miratuar me vendimin nr. 1363, datë 17.10.2008, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

PROJEKTMARRËVESHJE

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA TE MARRËVESHJA E KONCESIONIT NË LIDHJE
ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, PRONËSINË, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E NJË PROJEKTI PËR NJË HIDROCENTRAL TË RI
NË ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË NDËRMJET MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIËS DHE VERBUND AG (I REFERUAR MË PARË SI ÖSTERREICHISCHE
ELEKTRIZITÄTSWIRTSCHAFTS AKTIENGESELLSCHAFT) (KONCESIONARI) DHE
ENERGJI ASHTA SHPK (SHOQËRIA E PROJEKTTIT)
[.], 2016**

Kjo Marrëveshje (në vijim e referuar si “Marrëveshja”) lidhet në Tiranë, Shqipëri, sot më [.] 2016, nga dhe ndërmjet:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë, e cila vepron si ministria e linjës për sektorin e energjisë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 18.9.2013 “Mbi përcaktimin e qëllimit të përgjegjësisë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 840, datë 27.9.2013 (“Autoriteti Kontraktues”); dhe

2. Verbund AG (më parë i emërtuar Österrei-chische Elektrizitätswirtschafts Aktiengesellschaft), një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit austriak, e regjistruar pranë regjistrat të shoqërive pranë

Gjykatës Tregtare të Vjenës, me numër regjistrimi FN 76023z, me seli në Vjenë dhe adresë biznesi në: Am Hof 6A, 1011 Vjenë, Austri (“Koncesionari”); dhe

3. Energji Ashta sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila vepron në përputhje me ligjet e Shqipërisë, me seli ligjore pranë Hidrocentralit të Ashtës, në fshatin Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, rrethi Shkodër, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi NIPT – K82417005V, (“Shoqëria e Projektit”);

Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit do të referohen, gjithashtu, veçmas si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

HYRJE

Duke pasur parasysh që:

A. Më 30.9.2008, pas zhvillimit të procedurave ndërkombëtare të tenderimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (aktualisht e referuar si “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”) dhe Koncesionari lidhën marrëveshjen e koncesionit lidhur me projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (“Marrëveshja e Koncesionit”);

B. Në të njëjtën datë, Koncesionari dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. (“KESH”) lidhën: i) Marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga hidrocentrali i Ashtës (“Marrëveshja për Shitjen e Energjisë”); dhe ii) Marrëveshjen e Koordinimit të Kaskadës së lumit Drin (“Marrëveshja për Koordinimin e Kaskadës”), veçanërisht në lidhje me koordinimin e operimit dhe administrimit të kaskadës së lumit Drin në të cilën ndodhen hidrocentralet e operuara nga KESH-i, dhe Hidrocentrali i Ashtës (së bashku me Marrëveshjen e Koncesionit, Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjen për Koordinimin e Kaskadës, të referuara së bashku në vijim si “Marrëveshjet e Projektit”);

C. Më 9.2.2009, Koncesionari njoftoi Autoritetin Kontraktues për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve sipas Marrëveshjes së Koncesionit me të cilën Koncesionari mbetet personalisht dhe bashkërisht përgjegjës;

D. Më 31.3.2010, Koncesionari njoftoi KESH-in për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve të Koncesionarit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjes për Koordinimin e Kaskadës;

E. Si rrjedhojë e ndryshimeve në sektorin shqiptar të energjisë elektrike, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Shoqërisë së Projektit si Shitës të lejojë transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i, të shoqëria me kapital shtetëror, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (në vijim i referuar si “OSHEE”), e cila vepron aktualisht si Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Shqipëri;

F. Shoqëria e Projektit, KESH-i dhe OSHEE-ja kanë arritur një marrëveshje për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike nga KESH-i tek OSHEE-ja; Marrëveshja për Kalimin e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike e arritur ndërmjet Shoqërisë së Projektit, KESH-it dhe OSHEE-së është bashkëlidhur këtu si pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

G. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Koncesionit, e cila përmban disa parashikime me referenca krahasuese në rastin e mospërmbushjes nga ana e Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë; pra, transferimi i sugjeruar i të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë nga KESH-i tek OSHEE-ja kërkon kryerjen e disa ndryshimeve të Marrëveshja e Koncesionit; si dhe

H. Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria e Projektit si Shitës, kanë biseduar e rënë dakord mbi disa ndryshime dhe shtesa të Marrëveshja e Koncesionit, ndryshime të cilat janë të nevojshme si rrjedhojë e kalimit të propozuar të të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja;

Si rrjedhojë, duke pasur parasysh angazhimet e parashikuara këtu, mjaftueshmëria e të cilave është

pranuar, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizime

Shprehjet e përkufizuara në pjesë të tjera në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të përdoren dhe këtu me të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen e Koncesionit, me përjashtim nëse janë përkufizuar ndryshe në këtë Marrëveshje dhe kur kërkohet ndryshe nga konteksti i saj.

1.2 Interpretimi

Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me dispozitat interpretuese të Marrëveshjes së Koncesionit, me përjashtim kur kërkohet ndryshe nga konteksti i saj.

2. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë plotësisht në fuqi në datën më të vonshme midis periudhës së: i) plotësimit nga OSHEE-ja të Garancisë Bankare të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë; ii) miratimit të kësaj Marrëveshjeje nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (“Hyrja në fuqi”).

3. NDRYSHIMET E MARRËVESHJES E KONCESIONIT

3.1 Ndryshimet të nenit 1.1

Neni 1.1 i Marrëveshjes së Koncesionit ndryshohet si vijon:

3.1.1 Përkufizimi i termit “Autoritet Kontraktues” ndryshohet si më poshtë: “Autoritet Kontraktues” nënkupton ministrinë e linjës të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për energjinë, aktualisht e referuar si “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

3.1.2 Pas përkufizimit të termit “Faza operacionale” shtohet termi i përkufizuar si vijon: “OSHEE” nënkupton Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., operator i shpërndarjes së energjisë me kapital shtetëror shqiptar dhe furnizues publik i shitjes me pakicë, si dhe pasuesve dhe drejtëmarrësve të tij.

3.1.3 Përkufizimi i termit “Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve” ndryshohet si vijon: “Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve” nënkupton marrëveshjen merr ose paguaj, të lidhur në datën 30.9.2008, nga Koncesionari si Shitës dhe KESH-i si Blerës, në zbatim të tekstit të bashkëlidhur si shtojca A (Marrëveshja për Shitjen e Energjisë) të Marrëveshjes së Koncesionit, e cila iu delegua më vonë Shoqërisë së Projektit si Shitës dhe OSHEE-së si Blerës, në përputhje me kushtet dhe afatet e detyrave përkatëse.

3.1.4 Termi “Blerës” ndryshohet si vijon: “Blerës” nënkupton OSHEE-në.

3.2 Zëvendësimi i termave

3.2.1 Çdo referim të “METE” në Kontratën e Koncesionit zëvendësohet me termin “Autoritet Kontraktues”.

3.2.2 Në nenet 2.1(v), 4.1, 11.2.5(b), 11.2.5(c), 11.2.5(d), 11.3(a)(v)(x) dhe (y) të Marrëveshjes së Koncesionit, termi “KESH” zëvendësohet nga termi “OSHEE”.

4. SHITESAT E KONTRATËS E KONCESIONIT

4.1 Deklarimet dhe përfaqësimet nga Autoriteti Kontraktues

Në nenin 2.3 të Marrëveshjes së Koncesionit, pas paragrafit “c” shtohet një paragraf i ri “d” si vijon:

d) Nëse në çfarëdo momenti gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, e drejta: i) për të zgjedhur shumicën në këshillin drejtues (ose çdo organ tjetër drejtues) të OSHEE-së; ose ii) për të udhëhequr ndryshe administrimin dhe politikën e saj, transferohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një palë e tretë, e cila nuk është Entitet Shtetëror, atëherë, me kërkesën e shkruar të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që Marrëveshja për Shitjen e Energjisë t’i kalohet pa vonesa një entiteti apo shoqërie tjetër publike, të kontrolluar nga një Entitet Shtetëror, që të ketë një kredibilitet financiar të paktën të barasvlershëm me atë të OSHEE-së, në datën e kësaj Marrëveshjeje, me detyrimin për këtë entitet apo shoqëri tjetër publike për të përmbushur me përpikëri detyrimet e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë. Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të bëjnë, gjithashtu, ndryshimet e nevojshme në këtë Marrëveshje, për të reflektuar kalimin e Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

5. TË NDRYSHME

5.1 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe hyrjen e saj, përfaqëson të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me qëllimin e saj dhe i mbivendoset cilësdo dhe të gjitha marrëveshjeve apo masave të mëparshme ndërmjet të njëjtave Palë, pavarësisht nëse kanë qenë në formë verbale apo të shkruar, në lidhje me të njëjtin qëllim. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një instrumenti me shkrim të nënshkruar sipas rregullave nga Palët.

Kushtet dhe parashikimet e Marrëveshjes së Koncesionit do të mbeten të pandryshuara, me përjashtim të sa parashikohet shprehimisht këtu.

5.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti Korporativ

EA i përfaqëson dhe i garanton Autoritetit Kontraktues se janë marrë të gjitha miratimet e nevojshme paraprake korporatave dhe aksionare në lidhje me këtë Marrëveshje dhe se nënshkruesit përkatës kanë autoritetin e duhur korporativ për të lidhur këtë Marrëveshje.

5.3 Interpretimi i Marrëveshjes në tërësi

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo autoritet tjetër kompetent, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen në asnjë mënyrë.

5.4 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën angleze. Palët do të bien dakord mbi një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më parë të jetë e mundur pas nënshkrimit të versionit në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe.

5.5 Mosheqja dorë

Nuk do të konsiderohet se është hequr dorë nga asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje prej cilësdo Palë, me përjashtim kur kjo heqje dorë është kryer shprehimisht me shkrim. Mosinsistimi nga cilado prej Palëve për zbatimin rigoroz të cilësdo prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje apo përfitimi nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga cilado prej këtyre dispozitave apo heqje dorë nga ndonjëra prej të drejtave në të ardhmen.

Lidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga ajo dhe nuk ndikon tek asnjë prej të drejtave dhe/ose pretendimeve që Palët mund të kenë, të cilat lindin nga ose në lidhje me Marrëveshjet e Projektit, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe këtu.

5.6 Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

5.7 Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me Marrëveshjen do të zgjidhet në përputhje me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit.

Në dëshmi të kësaj, kjo Marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të Palëve, në datën e parë të shkruar më sipër.

[nënshkrimet vijojnë në faqen tjetër]

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIJË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

VERBUND AG

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

ENERGJI ASHTA sh.p.k.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

PROJEKTMARRËVESHJE

PËR KALIMIN E MARRËVESHJES SË SHITJES SË ENERGJISË NË LIDHJE ME NJË
PROJEKT TË RI HIDROCENTRALI NË ASHTË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË NDËRMJET
KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA ENERGJI ASHTA SHPK. DHE
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA

[.] 2016

Kjo Marrëveshje (në vijim e referuar si “Marrëveshja”) lidhet në Tiranë në datën [.] 2016 nga dhe ndërmjet:

1. Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë bllokut “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrisë Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi – NIPT J 61817005F, të përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga Z. Agron Hetoja, në cilësinë e drejtorit ekzekutiv/administratorit (në vijim i referuar si “KESH” ose “Ceduesi”); dhe

2. Energji Ashta sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Hidrocentralit të Ashtës, në fshatin Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, Rrethi Shkodër, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrisë Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik identifikimi NIPT – K82417005V, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga z. Dietmar Reiner dhe z. Peter Stelzer, në cilësinë e drejtorëve të përgjithshëm (në vijim e referuar, si: “EA”, “Shoqëria e Projektit” ose “Shitësi”); dhe

3. Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, me seli ligjore pranë Njesisë Bashkiake nr. 5, Rruga “Andon Zako Çajupi”, pallati Conad, kati i 3, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrisë Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik identifikimi – NIPT K72410014H, e përfaqësuar sipas rregullave në këtë Marrëveshje nga z. Adrian Çela në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv/Administratorit (në vijim e referuar si “OSHEE” ose “Përfituesi”).

KESH-i, EA dhe OSHEE referohen, gjithashtu, veçmas si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

HYRJE

Duke pasur parasysh që:

A. Më 30.9.2008, pas zhvillimit të procedurave ndërkombëtare të tenderimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (aktualisht e referuar si “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”) dhe Österreichische Elektrizitätswirtschafts Aktiengesellschaft (aktualisht e titulluar “Verbund AG” – në vijim referuar si “Koncesionari”) kanë lidhur marrëveshjen e koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e hidrocentralit të ri në Ashtë, Republika e Shqipërisë (“Marrëveshja e Koncesionit”);

B. Në të njëjtën datë, Koncesionari dhe KESH-i kanë lidhur: i) Marrëveshjen për shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga Hidrocentrali i Ashtës (Marrëveshja për Shitjen e Energjisë); dhe ii) Marrëveshjen e Koordinimit të Kaskadës së Lumit Drin (Marrëveshja për Koordinimin e Kaskadës), në veçanti, në lidhje me koordinimin e operimit dhe administrimit të kaskadës së lumit Drin, në të cilën ndodhen hidrocentralet e operuara nga KESH-i dhe Hidrocentrali i Ashtës (së bashku me Marrëveshjen e Koncesionit, Marrëveshja për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjen për Koordinimin e Kaskadës, të referuara bashkërisht në vijim si “Marrëveshjet e Projektit”);

C. Më 9.2.2009, Koncesionari njoftoi Autoritetin Kontraktues për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit, me të cilën Koncesionari mbetet personalisht dhe bashkërisht përgjegjës;

D. Më 31.3.2010, Koncesionari njoftoi KESH-in për kalimin të Shoqëria e Projektit të të drejtave e detyrimeve të Koncesionarit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë dhe Marrëveshjes për Koordinimin

e Kaskadës;

E. Nëpërmjet shkresës EA/KESH 027, njoftimi i datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë - Projekti i Hidrocentralit të Ashtës, EA njoftoi KESH-in se Marrëveshja për Shitjen e Energjisë ka hyrë në fuqi më 28.3.2013. Furnizimi me energji elektrike filloi më 1.4.2013;

F. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është lidhur për një periudhë pesëmbëdhjetë (15-vjeçare) nga hyrja në fuqi.

G. Si rrjedhojë e ndryshimeve në sektorin shqiptar të energjisë elektrike, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar EA-së transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja, shoqëri kjo me kapital shtetëror e cila vepron aktualisht si Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

H. EA, KESH dhe OSHEE kanë diskutuar dhe rënë dakord mbi kushtet për kalimin e marrëveshjes për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike nga KESH-i tek OSHEE-ja;

I. Marrëveshja për Shitjen e Energjisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Koncesionit, e cila përmban disa parashikime me referenca krahasuese për rastin e mospërmblidhjes nga ana e Blerësit, në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë; dhe transferimi i sugjeruar i të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja, kërkon kryerjen e disa ndryshimeve edhe në Marrëveshjen e Koncesionit;

J. Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe EA-ja kanë diskutuar dhe rënë dakord mbi ndryshimet të Marrëveshjes së Koncesionit, ndryshime të cilat janë të nevojshme si rrjedhojë e transferimit të propozuar të të drejtave dhe detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, nga KESH-i tek OSHEE-ja;

Si rrjedhojë, duke pasur parasysh angazhimet e parashikuara këtu, mjaftueshmëria e të cilave është pranuar, Palët bien dakord si më poshtë:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizime

Shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të përdoren këtu me të njëjtin kuptim që u është dhënë në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë, me përjashtim nëse janë të përkufizuara ndryshe nga kjo Marrëveshje dhe kur kërkohet ndryshe nga konteksti (duke përfshirë shtojcat e saj).

1.2 Interpretime

Kjo Marrëveshje interpretohet në përputhje me dispozitat interpretuese të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, përjashtuar nëse kërkohet ndryshe nga konteksti.

2. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë plotësisht në fuqi në datën më të vonshme midis periudhës së: i) plotësimit nga OSHEE të Garancisë Bankare të Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë; ii) miratimit të ndryshimeve në Marrëveshjen e Koncesionit të përmendura në pikën "J" të hyrjes këtu më lart ("Hyrja në fuqi") nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

3. KALIMI

Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe në zbatim të kushteve dhe afateve të saj, KESH-i në cilësinë e Ceduesit, i kalon OSHEE-së në cilësinë e Pranuesit, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Blerësit sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, dhe OSHEE si Pranues pranon këtë kalim dhe merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Blerësit (Ceduesit) sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë kundrejt EA-s si Shitës.

4. PAGESA E PRETENDIMEVE

KESH-i si Cedues dhe OSHEE-ja si Pranues, do të mbeten përgjegjës veçmas dhe bashkërisht ndaj EA-s në lidhje me çdo pretendim për pagesa të prapambetura në përputhje me Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë nga KESH-i, për periudha që i paraprijnë datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5. NDRYSHIMET TË MARRËVESHJES PËR SHITJEN E ENERGISË

5.1 Referencat te KESH-i

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo referencë te “KESH” në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me referencat ndaj “OSHEE-së”.

5.2 Referencat te METE

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, çdo referencë te “METE” në Marrëveshjen për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me referencat ndaj “Autoritetit Kontraktues” dhe përkufizimi përkatës i “METE-s” te neni 1.1 i Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë do të zëvendësohet me përkufizimin e mëposhtëm të termit “Autoriteti Kontraktues”:

“Autoriteti Kontraktues” nënkupton ministrinë e linjës të Republikës së Shqipërisë, përgjegjëse për sektorin e energjisë elektrike, aktualisht e emërtuar Ministria e Energjisë dhe Industrisë që vepron si Autoritet Kontraktues i Marrëveshjes së Koncesionit.

6. AFATI

Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje kryhet për afatin e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

7. TË NDRYSHME

7.1 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, duke përfshirë dhe hyrjen e saj, përfaqëson të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me qëllimin e saj dhe i mbivendoset cilësdo dhe të gjitha marrëveshjeve apo masave të mëparshme ndërmjet Palëve, në lidhje me të njëjtin qëllim, pavarësisht nëse kanë qenë në formë verbale apo të shkruar. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një instrumenti të shkruar të nënshkruar sipas rregullave nga Palët.

7.2 Përfaqësimet dhe Autoriteti Korporativ

KESH, EA dhe OSHEE përfaqësojnë dhe i garantojnë njëra-tjetrës se janë marrë të gjitha miratimet e nevojshme paraprake korporative dhe aksionare në lidhje me këtë Marrëveshje dhe se kjo Marrëveshje përmban detyrime të vlefshme dhe detyruese për Palën përkatëse, pasuesit ose drejtëmarrësit e tyre të autorizuar. KESH, EA dhe OSHEE përfaqësojnë dhe i garantojnë njëra-tjetrës se nënshkruesit përkatës kanë autoritetin e duhur korporativ për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të angazhuar Palën përkatëse.

7.3 Interpretimi i Marrëveshjes në tërësi

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme nga ndonjë autoritet gjyqësor apo autoritet tjetër kompetent, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten plotësisht në fuqi dhe nuk do të ndikohen në asnjë mënyrë.

7.4 Gjuha

Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet dhe zbatohet në gjuhën angleze. Palët do të bien dakord mbi një përkthim të saj në gjuhën shqipe sa më parë të jetë e mundur pas nënshkrimit të versionit në gjuhën angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi ndaj versionit në gjuhën shqipe. Çdo komunikim dhe njoftim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë do të kryhet në gjuhën angleze ose shqipe (së bashku me një përkthim në anglisht, nëse është e mundur).

7.5 Mosheqja dorë

Nuk do të konsiderohet heqje dorë nga asnjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, nga cilado Palë, me përjashtim kur kjo heqje dorë është kryer shprehimisht me shkrim. Mosinsistimi nga cilado prej Palëve për zbatimin rigoroz të cilësdo prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje apo përfitimi nga ndonjë prej të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga cilado prej këtyre dispozitave apo heqje dorë nga ndonjëra prej të drejtave në të ardhmen.

Lidhja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga ajo dhe nuk ndikon mbi asnjë prej të drejtave dhe/ose pretendimeve që Palët mund të kenë, të cilat lindin nga apo në lidhje me Marrëveshjet e Projektit.

7.6 Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Marrëveshje do të kryhet në zbatim të nenit 12.7

të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë tek adresat e mëposhtme:

Për KESH:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri.

Në vëmendje të: Drejtorit ekzekutiv/administratorit

Tel: +355 _____

Faks: +355 _____

Për EA:

ENERGJI ASHTA sh.p.k.

Hidrocentralli i Ashtës, fshati Spatharë, Bushat, Bashkia e Vaut të Dejës, rrethi Shkodër, Shqipëri

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm

Tel: +355 (4) 4504236

Faks: +355 (4) 4504236

Për OSHEE:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

Njësia Bashkiake nr. 5, rruga "Andon Zako Çajupi", pallati "Conad", kati 3, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Drejtorit ekzekutiv/administratorit

Tel: +355 _____

Fax: +355 _____

Adresat e mësipërme do të përdoren, gjithashtu, për njoftimet sipas Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë, me përjashtim nëse njoftohet një ndryshim adrese sipas nenit 12.7 të Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë.

7.7 Ligji rregullues

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

7.8 Mosmarrëveshjet

Në rast të ndonjë mosmarrëveshje mbi ose në lidhje me Marrëveshjen (Mosmarrëveshja), secila prej Palëve do t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim me shkrim për këtë, pas të cilit Palët do të takohen menjëherë dhe do të synojnë në mirëbesim të arrijnë një zgjidhje miqësore.

Në pamundësi të një marrëveshjeje miqësore brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të parashikuar më lart, cilado prej Palëve mund t'ia referojë këtë Mosmarrëveshje arbitrazhit ndërkombëtar.

Të gjitha procedimet e arbitrazhit në lidhje me sa më lart do të zhvillohen dhe zgjidhen përfundimisht në Paris, Francë dhe do të kryhen në zbatim të Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë para një komiteti prej 3 (tre) arbitrash të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentet e dërguara në lidhje me këto procedime do të jenë në gjuhën angleze ose të shoqëruara nga një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze.

Kjo Marrëveshje, si dhe Marrëveshja për Shitjen e Energjisë dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve do të mbeten në fuqi dhe efekt në pritje të vendimit në këtë procedim arbitrazhi, vendimi i cili, nëse është e përshtatshme, do të përcaktojë nëse dhe kur do të jetë efektive zgjidhja.

Në dëshmi sa më sipër, kjo Marrëveshje është nënshkruar nga përfaqësues të autorizuar sipas rregullave të Palëve në datën e parë të shkruar më sipër.

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE sh.a.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

ENERGJI ASHTA sh.p.k.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE sh.a.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____